



**HAPJA E DYERVE  
TË XHAMISË SË RE TE URA  
E BUNËS, GËZIM I MADH!**



**"EDUKONI FËMIJËT TUAJ  
ME DASHURI PËR PROFETIN  
MUHAMMED (A.S)"**



**DISA PYETJE  
RRETH NAMAZIT**

Viti 16 - Nr. 11 (189),  
Nëntor, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

# UDHA ISLAME

*E përmuajshme  
Informative - Fetare  
Kulturore - Edukative*

## **KEMI NEVOJË TË NGRIHEMI NGA GJENDJA E NEGLIZHENCËS DHE PASIVITETIT NË HAK TË FESË!**

**"E**rdhi Pejgamberi (a.s.) në mesin e arabëve në pranverën e parë, për të përjetuar arabët dhe mbarë bota vlerat reale të pranverës së besimit, jo siç provojnë sot mbi kurriz, ata dhe mbarë bota islame, pranverën e acartë të djegies, të shkatërrimit, të dhunës, të terrorizmit, të përçarjes, të keqleximit dhe keqinterpretimit të boshtit të kësaj feje të madhnueshme islame!"





**Imam Muhamed Sytari**  
Myfti i Zonës Shkodër

## KEMI NEVOJË TË NGRIHEMI NGA GJENDJA E NEGLIZHENCËS DHE PASIVITETIT NË HAK TË FESË!

All-llahu i Madhëruar me urtësinë e Tij na ka dhënë mundësi që herë pas here; edhe kur të kemi harruar për një moment a më shumë hakun e Resulull-llahut (a.s.) ndër ne, salavatit me dashni dhe pasimin mbi bazën e kësaj dashnie, që lidhet në të gjitha rrugët e saj me Krijuesin e gjithësisë; të na e freskojë memorien me përsëritjen e Hanës së lumturuar të muajit Rebiulevvel, në të dymbëdhjetën ditë të cilit, rreth 15 shekuj më parë, në vitin e largët 571, në një nga lagjet e Mekës, aty bri Qabes së Madhnueshme, erdhi në jetë një jetim, që do ta nxirrte njerëzimin nga errësira në dritë, me udhëzimin dhe mëshirën e Zotit të botëve!

Muhammed, ia vunë emrin! I biri i Abdull-llahut, nipi i plakut të urtë Abdullmuttalib, zinxhiri i trashëgimisë së të cilit mbërrinte deri tek Hz. Ismaili, djali i dashtun dhe i bindur i Hz. Ibrahimit (a.s.), të dërguarit që meritoi të thirrej: mik i All-llahut!

Rebiulevveli i sivjetshëm erdhi. Me zemër të mirë për mbarë ymetin islam! E gjeti botën tonë më të trazuar se kurrë. Tamam-tamam, ashtu si edhe ai muaj i pranverës së parë – (kështu i thonë në arabisht këtij muaji), që e

pat gjetur njeriun, arabët në veçanti, të shpërndarë e të hutuar, të zhytur në padrejtësi e injorancë, vëllavrasje e luftëra të padrejta, sundime tirane e pushtime egoiste, që arrinin deri në atë pikë, sa në Kur'anin Famëlartë lexojmë një sure me emrin e elefantit, ku mësojmë për dyndjen e Ebrehesë me elefantë e ushtri, me të cilën synonte të shembte dhe të shkatërronte Qaben e Madhnueshme... Deri në këtë pikë kishte mbërritur gjendja? Por, ashtu siç do të thoshte edhe i urti plak, Abdulmutalibi, gjyshi i jetimit, që ende s'kishte ardhur në këtë botë: "Kjo Shtëpi e ka një Zot që e mbron!" dhe, ashtu u dëshmuat..!

Erdhi Pejgamberi (a.s.) në mesin e arabëve në pranverën e parë, për të përjetuar arabët dhe mbarë bota vlerat reale të pranverës së besimit, jo siç provojnë sot mbi kurriz, ata dhe mbarë bota islame, pranverën e acartë të djegies, të shkatërrimit, të dhunës, të terrorizmit, të përçarjes, të keqleximit dhe keqinterpretimit të boshtit të kësaj feje të madhnueshme islame!

E gjeti botën të zhytur në mjegullnajën e dilemave të mëdha të përkatësisë dhe identitetit, rendjes pas zgjerimit të pushteteve dhe grumbullimit të forcës dhe pasurisë, neglizhencës brenda familjes, shtypjes së më të dobët dhe tendencës përherë në rritje të shfaqjes së kthetrave të njeriut të zhveshur nga besimi i drejtë dhe vullneti për t'u kthyer nga Krijuesi që e pret me mëshirë e falje..!

Çfarë ka ndodhur sot? Përse nuk ka një përpjekje nga secili prej nesh për të kapërcyer ca pengesa dhe për të kaluar

një prag, që na ndan nga ndjenja e pastër e dashnisë dhe mallit për Zotërinë e bijve të Ademit, për shfaqjen e të cilit në këtë botë, All-llahu i Madhëruar shpalli në Kur'an: "Është e vërtetë se All-llahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi një të dërguar që atyre t'u lexojë argumentet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Librin dhe Urtësinë, edhe pse më parë ata ishin krejtësisht të humbur".<sup>1</sup>

Pra, në një mënyrë a një tjetër, sot kemi nevojë të ngrihemi nga gjendja e neglizhencës dhe pasivitetit në hak të fesë, të kuptojmë drejtë se Hz. Muhammedi (a.s.) është DHURATË e madhe nga Zoti i gjithësisë për njeriun dhe jetën në këtë univers! Dhe se, kjo dhuratë e madhe, shoqërohet me leximin e argumenteve të Tij, edukimin e brendshëm të nefsit, pastrimin e tij, si dhe mësimin e Librit dhe Urtësisë!

A e kemi bërë ne këtë? A e kemi lexuar drejtë Librin, a kemi kërkuar për mësuësin e Librit, edukatorin e nefsit, udhërrëfyesin drejt urtësisë? A e kemi lexuar me hollësi thënien e tij (a.s.): "Ata, që më së shumti më duan nga ymeti im, janë një popull pas meje. Do të dëshironte ndonjëri prej tyre të jepte familjen dhe pasurinë e tij, vetëm të më shihte"<sup>2</sup>, me qëllimin e matjes së

1. Kur'ani, Ali Imran: 164.

2. Transmetuar nga Imam Ahmedi në "El-Musned", nga Ebu Dherri (r.a). (Thotë Imam El-Mennavi në "Fejdul-Kadir": "Ky hadith është prej mrekuallive të tij (a.s.), kur ka folur për të panjohurën... Kjo i ka ndodhur shumë prej sufive të mëdhenj, që janë lartësuar në gradën e shikueshmërisë së tij (a.s.) në vazhdimësi. Thotë Arif El-Mursi: "Pasha All-llahun, sikur të fshihej

gjendjes sonë në raport me këtë dëshmi hyjnore? Me fjalë të tjera: A e duam dhe sa e duam ne sot, të Dërguarin e All-llahut? Por, përpara kësaj, sa e njohim dhe sa e lexojmë ne atë?

A nuk është fillimi i këtij muaji të begatë, një mundësi më shumë për të lexuar drejtë ajetin kur'anor: "Apo, mos nuk e njohin të dërguarin e vet (Muhammedin), prandaj e refuzojnë?"<sup>3</sup>, në rrugëtimet tona për ta njohur dhe kuptuar përherë e më drejtë dhe thellësisht të Dërguarin e All-llahut (a.s.), shembullin e tij; fjalën dhe veprën e tij, miratimin dhe heshtjen e tij, luftën dhe paqen e tij, lutjen dhe adhurimin e tij, përpjekjen dhe qëndrueshmërinë e tij në Thirrjen Islame, por jo vetëm?

A nuk është përkujtimi i ditës së ardhjes së tij në këtë botë, një frymëzim më shumë për gjithsecilin prej nesh, për ta bërë këtë ditë, një moment më shumë për t'u afruar me besimin dhe fetarizmin, me adhurimin dhe përmirësimin e gjendjes, me pendimin dhe kthimin e vendosur nga ajo derë e madhe, që s'mbyllet kurrë në fytyrat e kërkuesve të lartësive?

Thoshte (a.s.): "Ajo është një ditë në të cilën unë kam lindur!"<sup>4</sup>, ndërsa Hoxha i jonë H. Vehbi Sulejman Gavoçi, në lidhje me këtë, thekson: "Shohim se ai Zotëri (a.s.) përmendi ditëlindjen e tij dhe na mësoi me e ditë atë ditë të bekuar. Para qindra vjetësh dhe deri sot, ulematë në hadith, tefsir, fikh etj., kanë festuar dhe e festojnë ditëlindjen e Profetit (a.s.)! Kanë lexuar jetën e Profetit (a.s.) në disa faqe të zgjedhura. Kanë lavdëruar cilësitë e tij, siç e ka lavdëruar Hassani përpara vetë Profetit (a.s.), kanë rënë salavatë mbi Pejgamberin (a.s.) me qindra herë..."<sup>5</sup> Po ne, pse po lejojmë të na zbehët kjo dashni dhe kjo shfaqje e mrekuallueshme e saj, nëpërmjet aktiviteteve dhe tubimeve, ligjëratave dhe këndimeve, dhënies së sadekave dhe nxitjes së pasimit të tij (a.s.)?

A nuk është koha të sillemi me zemër nga kërkimi i kësaj dashnie të madhe që nuk na lë të devijojmë e të rrëshqasim, edhe pse përherë mendojmë se po veprojmë më të mirën; edhe kur gabojmë, edhe kur i hyjmë në hak të tjerëve, edhe kur heshtim në kohën kur

prej meje pamja e Resulull-llahut (a.s.), sa hap e mbyll sytë, nuk do ta konsideroja më veten prej muslimanëve!". – Shih: "Fejdul-Kadir", botimi i parë, Bejrut, 1996, vëll. I, f. 649).

3. Kur'ani, El-Mu'minune: 69.

4. Transmetim i Imam Muslimit.

5. Vehbi S. Gavoçi, "Njohuri rreth Kur'anit – Synteti e bidati", Shkodër, 1999, f. 125.

duhet folur, edhe kur nuk ngrihemi për ta ndryshuar të keqen në një kohë që ajo ka kaluar në ekstrem shkatërrues, edhe kur nuk gjejmë forcën për të thënë një fjalë të mirë nga ndrojtja a frika e paragjykit, edhe kur nuk reagojmë me urtësi dhe krenari kur lëndohemi e përcmohemi nga misionarët e përçarjes dhe intolerancës ndaj muslimanëve sot në botë, edhe kur..., edhe kur..!

Ndërkohë, Resulull-llahu (a.s.) e thoshte haptas, me zemër të lënduar, por me shpresë të madhe: "Shembulli im dhe shembulli juaj është si puna e një personi që ka ndezur një zjarr, në të cilin fluturat dhe karkalecat vijnë e hidhen në të, ndërsa ai i largon me dorë që mos të bien. Edhe unë mendohej t'ju largoj nga zjarri e ju më ikni nga duart".<sup>6</sup>

Sot, të dashurit e mi, tekta ju uroj me zemër hyrjen e këtij Muaji të begatë, që zgjon zemrat nga hutimi, mendjet nga plogështia dhe gjendjen tonë nga pasiviteti regresist, ju ftoj të kuptoni thelbin e thirrjes hyjnore: "Mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët u ruhen (gjynaheve), e japin zekatin dhe për ata që i besojnë argumentet tona. (157) Të cilët e pasojnë të dërguarin (Muhammedin), profetin analfabet, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), tek ata në Teurat dhe në Inxhil, që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që u zbrit me të, TË TILLËT JANË TË SHPËTUARIT!"<sup>7</sup>

Kjo është thirrja, rreth së cilës ia vlen të mendojmë e të reflektojmë, në rrugëtimin tonë në kërkim të fillit të artë të asaj dashnie, për të cilën i Dërguari (a.s.) ndjehej krenar dhe i bindur se: "Ata, që më së shumti më duan nga ymeti im, janë një popull pas meje. Do të dëshironte ndonjëri prej tyre të jepte familjen dhe pasurinë e tij, vetëm të më shihte".<sup>8</sup>

A jeni të gatshëm për t'iu përgjigjur kësaj dëshmie-sfidë?

(Hytheja e mbajtur në xhaminë e Parrucës, më 1 Rebiulevvel 1440 / 9 nëntor 2018)

6. Ahmedi dhe Muslimi, nga Xhabiri (r.a).

7. Kur'ani, El-A'rafë: 156-157.

8. Transmetuar nga Imam Ahmedi në "El-Musned", nga Ebu Dherri (r.a).



**PEJGAMBERI (A.S.) KA THËNË:  
"AJO ËSHTË NJË DITË  
NË TË CILËN UNË KAM LINDUR!"**

**"Shohim se ai Zotëri (a.s.) përmendi ditëlindjen e tij dhe na mësoi me e ditë**

**atë ditë të bekuar.**

**Para qindra vjetësh dhe deri sot, ulematë**

**në hadith, tefsir, fikh etj, kanë festuar dhe e**

**festojnë ditëlindjen e**

**Profetit (a.s.).**

**Kanë lexuar jetën e**

**Profetit (a.s.) në disa**

**faqe të zgjedhura.**

**Kanë lavdëruar cilësitë**

**e tij, siç e ka lavdëruar**

**Hassani përpara vetë**

**Profetit (a.s.), kanë rënë**

**salavatë mbi**

**Pejgamberin (a.s.)**

**me qindra herë...".**

**H. Vehbi Sulejman Gavoçi**

*(rahmet pastë)*

**"Ata, që më së shumti më duan nga ymeti im, janë një popull pas meje. Do të dëshironte ndonjëri prej tyre të jepte familjen dhe pasurinë e tij, vetëm të më shihte"**



**D**evotshmëria është një ndër tiparet më dalluese të myslimanit. Për këtë arsye edhe Allahu (xh.sh.) në Librin e Tij i ka lavdëruar të devotshmit duke bërë me dije se shpëtimi, qetësia dhe lumturia arrihen vetëm përmes devotshmërisë.

Në ajetin 197 të sures Bekare thuhet: "...Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria..."

Krijuesi i gjithësisë ka përsëritur më shpesh çështjet të cilat janë të një rëndësie të veçantë. Në këtë aspekt në Kur'anin Famëllartë fjala devotshmëri ceket në 258 vende duke dëshmuar rëndësinë e saj. Tani le të flasim për cilësitë e të devotshmëve:

I devotshmi është përherë punëmirë. Gjithashtu është mbrojtës i të mirës dhe i punëmirë. Adhurimet i kryen me një qetësi dhe durim shembullor. Në Kur'anin Famëllartë kjo gjendje përshkruhet kështu: "Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zeqatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun". (El-Bekare, 177)

I devotshmi kujdeset që të ketë një moral të duhur dhe të pastër, që sjelljet dhe fjalët të jenë në përputhje me njëra tjetrën, e që modeli i tij të jetë Pjegamberi (a.s) duke u mbështjellë me moralin e atij zotëri.

Të devotshmit ndihmojnë njëri tjetrin në mirësi, punë të mira, apo çdo çështje tjetër që ka të bëjë me devotshmërinë duke u solidarizuar e bashkuar për një qëllim të vetëm. Ata nuk ka gjasa të bëhen një në çështje të së keqes, armiqësisë apo gjynaheve por përkundrazi... Kur'ani Famëllartë përshkruan: "...Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër". (El-Maide, 2)

Të devotshmit edhe kur janë të pasur por edhe në skamje japin në rrugën e Zotit aq sa kanë mundësi. Shtypin zemërimin dhe i falin njerëzit. Kur'ani e përshkruan këtë situatë si më poshtë: "...të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur

## AJETET E DEVOTSHMËRISË

janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit". (Ali Imran, 134)

Po ashtu të devotshmit janë ata të cilët kur bëjnë mëkat pendohen me sinqeritet dhe nuk i kthehen më gjynahit, sepse ata nuk mund të jenë të qetë kur gabojnë. Kur'ani për këtë përshkruan: "Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre – e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë mevetëdije në gabimet që kanë bërë...". (Ali Imran, 135)

Po ashtu ata nuk i ndahen kurrë së drejtës, sepse e drejta është cilësi e pandashme e myslimanit. Drejtësi në

**I devotshmi kujdeset që të ketë një moral të duhur dhe të pastër, që sjelljet dhe fjalët të jenë në përputhje me njëra tjetrën, e që modeli i tij të jetë Pjegamberi (a.s) duke u mbështjellë me moralin e atij zotëri.**

gjeste, në vepra, në fjalë. Krijuesi i Gjithësisë shprehet kështu në këto dy ajete: "O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën". (El-Ahzab, 70)

"Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar". (Hud, 112)

Ata nuk marrin ndonjë vendim pa u konsultuar, konsulta është një çështje e rëndësishme për çdo mysliman. Konsultohen për çdo çështje në mënyrë që të mos gabojnë në punën e tyre. Edhe Kur'ani edhe Pjegamberi i kanë dhënë një rëndësi të veçantë konsultimit. Madje në Kur'an nja sure mban emrin Surja Shu ra- Surja e Konsultimit. Pjegamberi konsultohej me shokët e tij në mënyrë të vazhdueshme. Kush pyet nuk humbet kanë thënë të moçmit. Në ajetin 38 të Sures Shura thuhet: "... dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin..."

Nëse analizojmë ajetet Kur'anore në lidhje me takvanë-devotshmërinë kuptojmë së ajo na mëson ti respektojmë njëri-tjetrin dhe të drejtat e tyre. Kësisoj të devotshmit i ruhen shumë hakut të

robit duke qenë të bindur se një çështje e tillë është e pafalshme tek Allahu. Për këtë arsye kur flitet për të drejtat e njeriut na shfaqet përpara edhe termi drejtësi, sepse në të vërtetë edhe lidhja midis devotshmërisë dhe drejtësisë është shumë e fortë. Në Kur'an thuhet: "...Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë... (El-Maide, 8)

Çdo njeri është krijuar nga një nënë dhe baba. Shumëfishimi i njerëzimit ka sjellur me vete procesin e ndarjes në fise e kombësi. Ngjyrat, racat, gjuhët janë të shumëllojta. Por pozita më e lartë tek Allahu është pozita e të devotshmit. Për këtë në Kur'an thuhet: "O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë". (El-Huxhurat, 13)

Ata të cilët i binden urdhrave të Allahut dhe largohen nga gjithçka ka ndaluar Ai duke shfaqur një sjellje sipas pëlqimit të Tij, vendbanimi i tyre i fundit do të jetë Xhenneti. Në Kur'an thuhet: "... pra, për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!...". (Ali Imran, 136)

Nuk ka frikë dhe brengë për të devotshmit. Ata janë njerëz të lumtur dhe të qetë si në këtë ashtu edhe në botën tjetër. Superioriteti sipas Kur'anit qëndron vetëm në punët e mira dhe të bukura. Të devotshmit pikërisht këtë bëjnë. Nuk duhet harruar se zemrat sprovohen me devotshmërinë. E kjo botë nuk është gjë tjetër vetëm se një stacion ku sprovat venë e vijnë. I devotshëm është ai i cili këto sprova i kalon me dinjitet. Pjegamberi ynë (s.a.v.s) na ka porositur të themi: "O Allah, kërkoj prej Teje, udhëzim, devotshmëri, nder dhe pasuri." (Muslim, Dhikr, 72) Ai Zotëri edhe pse pjegamber i është lutur Zotit për devotshmëri...

Zoti i Gjithësisë i mundësoftë krejt myslimanëve një jetë me devotshmëri. Amin...

Autor: **Sami Gökün,**  
(Revista:YÜZAKI, Korrik 2018)

Përktheu dhe përshtati

**Elna SYTARI**

## "40 HADITHE PROFETIKE" NJË LIBËR ME VLERA FETARE DHE SHKENCORE

**K**ohët e fundit ka dalë nga botimi libri i Ma. Gilman Selim Kazazit "40 HADITHE PROFETIKE" (2018), botim i shtëpisë botuese "Progresi" në Shkodër, që ka tërhequr shumë lexues për tematikën që trajton dhe zgjidhjet që ofron.

Libri "40 Hadithe Profetike" i sjellë në shqip nga Ma. Gilman S. Kazazi, është libri më i ri i autorit i sjellë për lexuesin musliman shkodran dhe shqiptarë. Dyzet hadithet e përmendura në libër janë të përmbledhura dhe të përzgjedhura nga dijetari njohur shqiptarë, Abdul Kadir Arnauti, e janë përkthyer dhe përshtatur në shqip, si dhe janë shoqëruar me komentime nga Ma. Gilman S. Kazazi.

Tematikat e haditheve të librit janë të ndryshme. Mund t'i ndajmë në disa kategori si: në hadithe që flasim për bazat e besimit e të Islamit. Hadithe që flasin për etikën dhe moralin islam. Hadithe që flasin për shpërblimin e disa punëve të mira dhe që nxisin për to. Hadithe që flasin për disa shenja të ditës së kiametit.


Dijetari i madh i hadithit Abdul Kadir Arnauti në përmbledhjen e dyzet haditheve në një libërth të vetëm, ka ndjekur rrugën e shumë dijetarëve të shquar, të cilët që në shekullin e dytë të hixhretit kanë përmbledhur vepra të tilla që në terminologjinë e shkencës së hadithit quhen: "Exhzaa hadithijeh".

Autori, në komentimin e haditheve ka ndjekur rrugën e mesme duke mos u zgjatur shumë në komentim, por as edhe duke e lënë të mangët atë. Komentimi ka ardhur i qartë, e i lehtë për t'u kuptuar. I drejtpërdrejtë dhe i ndarë në paragrafë, ku në secilin paragraf trajtohet një pjesë e hadithit, siç edhe mund të shihet qartë nga shfletimi i librit.

Komentimi i haditheve ka ardhur në formë mësimesh dhe dobish, sepse, siç shprehet edhe autori në parathënieën e tij, ky libër përpara se të dalë në dritë është ideuar në formë dershesh. Autori thotë: "...shërbimi që po ofroj në këtë libërth është përcjellja e një reflektimi të shpejtë dhe shpalosja e disa mësimëve dhe dobive të përfrituara nga leximi i përmbledhjes së haditheve me xhematin e xhamisë së madhe "Ebu Bekër" në Shkodër".<sup>1</sup>

Gjithashtu kjo mënyrë e zgjedhur

1.5 Dyzet hadithe profetike, f. 4.



**"Kushdo nga ymeti im që mëson dhe kupton dyzet hadithe rreth fesë tij, ai ditën e gjykimit do të ringjallet në taborin e ulemave"**

ndihmon në ngulitjen e mësimëve profetike në mendjen e lexuesit, duke e mbajtur atë larg fjalëve të shumta dhe interpretimeve e mendimeve të dijetarëve të tepërta - për xhematin tonë - të cilat largojnë vëmendjen e lexuesit nga thelbi i hadithit dhe mesazhit që ai përcjellë.

### PSE DYZET HADITHE DHE AS MË PAK E AS MË TEPËR?

Në trashëgiminë kulturore dhe intelektuale islame gjejmë shumë libra të fushës së hadithit profetik, të cilët kanë përmbledhur nga dyzet hadithe. Llojshmëria e përmbajtjeve dhe tematikave të tyre varion dhe përfshinë një numër të madh tematikash siç janë: teuhidi, fikhu, zuhdi, dhe të përziera etj, siç shprehet edhe dijetari i njohur Ibn Asakir<sup>2</sup>.

2. El-Erbaun El-Buldaniye, fq. 35-36, Ibn Asakir.

Por cili është motivi i përzgjedhjes së këtij numri dhe jo një tjetri?! Padyshim që pas kësaj qëndron diçka dhe nuk është rastësi. Motivi e kësaj pune, është hadithi Profetik i cili thotë: "Kushdo nga ymeti im që mëson dhe kupton dyzet hadithe rreth fesë tij, ai ditën e gjykimit do të ringjallet në taborin e ulemave"<sup>3</sup>.

Ndër dijetarët e parë që kanë përmbledhur dyzet hadithe ka qenë Abdullah ibn Mubarek (v. 181h), siç shprehet imam Neveviu në parathënieën e librit të tij, "El-Erbeun En-Nevevije"<sup>4</sup>.

Në fund, e lusim Allahun që dijetarin e madh Abdul Kadir Arnauti ta mbulojë me mëshirën e Tij të pakufishme e ta ringjallë në taborin e dijetarëve dhe, Ma. Gilmanin S. Kazazi ta begatojë me mirësi e sukses në shërbim të fesë e të vendit, e ta shpërblejë në dynja dhe në ahiret.

### BOTIME TË TJERA TË AUTORIT:

1. "Mbi traditën Profetike..." - Shkodër, 2012.
2. "Një e treta e Kur'anit" - Shkodër, 2013.
3. "Për fjalën më të bukur" - Shkodër, 2013.
4. "Vendi më i dashur" - Shkodër, 2014.
5. "Në lulishten e mendimeve" - Shkodër, 2015.
6. "Toka e Shenjtë" - Shkodër, 2016.
7. "Largohuni nga risitë në besim" - Shkodër, 2016
8. "Disiplina e dijetarëve Muslimanë" - Shkodër, 2017.
9. "Udhëzues metodik për mësimin e Kur'anit përmendësh" - Shkodër, 2017.
10. "Zekati i Diturisë" - Nëntor 2017.
11. "Poezia e Texhvidit" - Shkodër, 2017.
12. "40 Hadithe mbi Xhamitë" - Shkodër, 2018.
13. "Lule Sabahu" - Shkodër, 2018.

**Prof. dr. Njazi KAZAZI**  
**Durim KASEMI,** teolog

3. Ky hadith është transmetuar nga Ibn Hibani në El-Mexhruhijn.

4. El-Fet'hu El-Mubin bi sherh el erbein, fq. 107, Ibn Haxher El-Hejtemij.

### SIRIA, OSE TOKA E BEKUAR E "SHAMIT"

Toka e njohur në botën perëndimore me emrin "Levant", sot përfshin në gjirin e saj disa shtete, por në kohërat e lashta njëhej si një vend i vetëm, i mirë dhe i bekuar.

Në Kur'anin famëlartë dhe në Sunetin e të Dërguarit të Zotit (a.s), kjo tokë përmendet si një vend i bekuar dhe me vlerë të veçantë.

Levanti, apo "Shami" - emër me të cilin njihet në botën arabe, përfshin brenda tij Palestinën, Sirinë, Jordaninë dhe Libanin.

Përsa i përket zonës së Palestinës, dihet botërisht se ajo është një tokë e shenjtë, sepse aty gjendet Xhamia Aksa. Pastaj, nga katër shtetet që i përmendëm më parë, të cilat i përfshin toka e Levantit - Shamit, më i madhi prej këtyre shteteve, për nga sipërfaqja, është Siria.

Në fakt, sapo përmendet emri Sham, menjëherë mendja të shkon në Siri.

ndërsa popullsia e vendit, në vitin 2013, arrinte në 22.5 milionë banorë. Halebi (Aleppo) është qyteti më i madh në Siri, ndërsa Damasku është qyteti që ka numrin më të madh të banorëve.

Ky vend, i karakterizuar nga fusha pjellore, male dhe lugina, është vatra e një popullsie të përbërë nga arabë, kurdë, armenë dhe asirianë. Në vend ka disa fe të ndryshme, ku padyshim, dominon Islami.

Siria gëzon një terren të llojllojshëm. Në jugperëndim të saj gjenden lartësitë e Golanit, fusha pjellore Hauran dhe në jug të saj gjendet "Mali i Arabëve", i cili përbëhet kryesisht nga shkëmbinj bazalt. Në perëndim të Sirisë, në kufirin me Libanin, shtrihet vargmali në të cilin gjendet pika më e lartë në Siri, në majën e "Malit të Shejkhit". Terreni sirian përfshin fusha pjellore, të tilla si Gouta e Damaskut. Në veri të Sirisë janë malet e Sem'an, në juglindje gjendet Shkretëtira e Sirisë dhe Malet Tedmur

nga klimë e thatë, shumë e ftohtë gjatë dimrit, shumë e nxehtë gjatë verës dhe me reshje të pakta. Në zonat malore, gjatë verës, temperaturat janë mesatare, ndërsa në malësitë perëndimore, zakonisht në janar, bie borë.

#### HISTORIA

Në tokën e Sirisë, qytetërimet ndoqën njëri-tjetrin. Kjo për shkak të prurjeve njerëzore që vinin ose nga veriu (nga malet e Anadollit), ose nga deti, në kërkim të një jete më të mirë atje, për shkak të pozicionit strategjik të vendit, sepse Siria ka qenë vendtakimi i gjithë botës së lashtë. Gjithsesi, këto prurje njerëzore, kryesisht ushtarake, nuk e ndryshuan natyrën e banorëve autoktonë vendas, të cilët kishin ardhur e ishin vendosur aty qysh në shekujt e hershëm, nga jugu e nga Gadishulli Arabik dhe që ishin shpërndarë gjithkund brenda territorit të Shamit, që nga cepi i gadishullit Arabik, në Mesopotami, deri në jug të Palestinës e në Sinai. Në ato toka erdhën fise Akadianë, pastaj më vonë fise Amorite (mileniumi i tretë p.e.s), Kan'anë dhe Fenikas (banorët e bregdetit), pastaj Aramej (popullsia e zonave të sipërme), si edhe Gasasinë dhe Enbaatë (emigrimet e fundit). Migrimet e njëpasnjëshme të fiseve me origjinë arabe, e konfirmuan natyrën arabe të popullsisë së Sirisë, që nga agimi i historisë, prandaj ata mundën t'u bëjnë ballë të gjitha prurjeve ushtarake që e sulmuan vendin më vonë, si Hititët, Persianët, Grekët dhe Romakët.

Kur erdhi ushtria Arabe Islame në tokat e Shamit, në vitin 636, identiteti arab i këtyre vendeve u konfirmua plotësisht. Pas këtij momenti, gjithçka u pastrua nga "ndryshku" i lënë nga pushtimet e ndryshme, dhe vendi u kthye në thelbin dhe në origjinalitetin e vet arab.

\*\*\*

Siria është përshkruar gjithmonë si vendi "përmbledhës i historisë së botës". Gjithë civilizimet e mëdha në ecurinë e njerëzimit, ose kanë lindur pikërisht aty, ose patjetër kanë ndërvepruar në atë vend. Dituria, risitë, progresi i njerëzimit, zbulimet shkencore, fetë, lindën ose u ripërtërinë në Siri. Toka e këtij vendi i akumuloi

thirrur në Islam.

Mesazhet e Profetit drejtuar mbretërve, princërve, udhëheqësve të kombeve dhe të popujve, të fiseve dhe grupeve në kohën e tij, ka qenë një faqe e shquar e biografsë së Profetit dhe e historisë Islame, sepse këto mesazhe zbulojnë një anë të zbatimit konkret të Islamit dhe shfaqin natyrën universale që kjo thirrje mbart. Pikërisht gjatë kësaj kohe, i Dërguari i Allahut i pati dërguar mesazh, me anë të të cilit e ftonte në Islam, edhe perandorit romak Herakliut (Flavius Heraclius Augustus), i cili në atë kohë sundonte edhe tokat e Shamit, përfshirë Sirinë.

Akoma edhe sot ai mesazh ruhet në muzeun e Stambollit dhe kjo këtu poshtë është një foto e marrë pikërisht në atë muze.

Buhariu dhe Muslimi, edhe dijetarë të tjerë të hadithit, e kanë përcjellë të plotë ngjarjen, se si perandori romak e kishte pritur mesazhin e Profetit Muhamed, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Ndërsa mesazhi vetë përmban këto fjalë: "Ne emër te Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. (Kjo letër është) Nga Muhammedi, robi i Allahut dhe i dërguari i Tij, për tek Herakliu, i madhi i romakëve. Paqja qoftë mbi atë që ndjek rrugën e drejtë! Më tej, unë të ftoj ty në Islam. Bëhu musliman që të jesh i shpëtuar, dhe gjithashtu Zoti do të të japë shpërbllim të dyfishtë. E nëse ia kthen shpinën kësaj ftese, atëherë mbi ty do të rëndojë gjithë gjynahu i arianëve. Dhe "O Njerëzit e Librave të shenjtë! Ejani në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!" Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju të dëshmojnë se ne jemi muslimanë (të nënshtruar Zotit)" – (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Herakliu e mori mesazhin e Profetit (a.s) dhe e hetoi këtë çështje, siç tregohet në hadithin e gjatë dhe të famshëm që flet për bisedën që u zhvillua mes tij dhe Ebu Sufjanit, kur ai e pyeti për Profetin (a.s). Pastaj ai i pati thënë Ebu Sufjanit: "Nëse gjithë ajo

që thua është e vërtetë, atëherë pra ai do ta zotërojë edhe tokën mbi të cilën i kam këmbët unë tani. E dija se ky Profet do të dilte, por nuk mendoja se do të ishte prej jush (prej arabëve). Po të isha i sigurt se do të mbërrija shëndosh e mirë tek ai, do ta merrja mundimin për ta takuar. e po të isha pranë tij, do t'ia laja këmbët." – (Buhariu)

\*\*\*



Në të vërtetë, Islami filloi të hyjë në vendet e Shamit qysh në kohën e kalifit Ebu Bekr (r.a). Ai dërgoi një ushtri të cilën e kishte përgatitur vetë i Dërguari i Zotit kur ai ishte akoma në këtë jetë dhe që udhëhiqej nga Usama ibn Zejd. I Dërguari i Zotit e pati përgatitur këtë ushtri me qëllim që të zbrapste sulmet romake në kufijtë e Gadishullit Arabik. Komandant Usama ibn Zejd (r.a), vërtetë arriti të ketë sukses në zbrapsjen e sulmeve romake. Pastaj më vonë, Ebu Bekri (r.a), i pati kërkuar gjeneralit të luftës, Halid ibn El Velid, të shkonte dhe të vihej në krye të katër ushtrive muslimane që gjendeshin asokohe në Sham. Në Betejën e Exhnadinit, Halid ibnul-Velidi, arriti ta organizojë mirë ushtrinë dhe të merrte lindjen dhe veriun e Palestinës. Ndërsa, në epokën e Omer ibnul-Hattabit, muslimanët arritën të kenë nën zotërim gjithë vendet e Shamit, ku çelësi i fitores pati qenë suksesit në betejën e Jermukut, në vitin 636. Në betejën e Jermukut, muslimanët dolën fitimtarë, ndërsa romakët u mundën për të mos u kthyer më kurrë në tokat e Shamit.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe



#### RELIEVI

Republika Arabe e Sirisë ndodhet në pjesën perëndimore të kontinentit të Azisë, ku ana perëndimore e vendit shtrihet përgjatë Detit Mesdhe, me një vijë bregdetare deri në 193 km.

Siria kufizohet në veri me Turqinë, në lindje dhe juglindje me Irakun, në jug kufizohet me Mbretërinë e Jordanisë, nga perëndimi me Detin Mesdhe dhe me Libanin, dhe në jugperëndim kufizohet me Palestinën. Sipërfaqja e Republikës Arabe të Sirisë arrin në 185.000 km²,

(Palmira) gjenden në pjesën qendrore të saj. Siria ka një ishull të vetëm, ishullin Ervaad, që gjendet përballë Tartus-it, një qytet në bregun mesdhetar të vendit.

#### KLIMA

Siria karakterizohet nga dy ndarje të mëdha klimaterike. Në zonat bregdetare dhe në tokat e afërta me të mbizotëron klima mesdhetare, e ngrohtë në verë dhe e thatë në dimër, e freskët dhe me shi gjatë pranverës dhe vjeshtës. Ndërsa pjesa tjetër e rajoneve karakterizohet

## “EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)” - DR. MUHAMMED A. JEMANI

(LIBËR I PËRKTHYER NGA H. VEHBİ S. GAVOÇI - SHKODËR, 1996)

### PROFETI MUHAMMED (A.S) NË LIBRAT HYJNORË

Në librat që përshkruajnë jetën e Profetit Muhammed (a.s) theksohet gjithnjë se Profetët e parë, e veçanërisht Hz. Isai (a.s), (Jezusi) ka përgëzuar për ardhjen e Profetit (a.s). Në librat që u janë zbritur nga Zoti (xh.sh), ashtu siç është përmendur edhe në Kur'an, thuhet: “Ky është Profet, i dërguar nga Zoti (xh.sh)”

Kur'ani Famëlartë është libri që nuk ka pësuar as më të voglin ndryshim, sepse vetë Zoti (xh.sh) ka dashur ta ruajë. Dhe ashtu ka ngjarë.

Ne e dimë se Teurati dhe Ungjilli janë ruajtur, por me ndryshime, me shtojca e mungesa. Kjo është e ditur pa as më të voglin dyshim.<sup>1</sup>

Po përshkruaj disa ajete nga librat e shenjtë për Profetin Muhammed (a.s).

### NË KUR'AN, LIBRI QË IU ZBRIT MUHAMMEDIT (A.S)

Në Kur'anin famëlartë thuhet: “Përkujtoni (o ithtarët librit) kur Allahu mori zotimin e Pejgamberëve: nga ajo se juve ju dhashë libër e urtësi, ju patjetër do ta besoni e do ta ndihmoni pejgamberin që vjen pas jush e që vërteton atë që ju keni pranë vetes.

1. Lexo: “Muhammedi në katër ungjijtë”, shkruar nga francezi Moris Bukaj, i cili pranoi fenë islame.

Tha (Allahu): “A pranuat, a e morët përsipër obligimin Tim?” Ata thanë: “Ne e pranuat!” Tha Allahu: “Dëshmoni pra, edhe unë dëshmoj bashkë me ju. E kush thyen këtë zotim, ata janë jashtë respektit ndaj Allahut.”<sup>2</sup>

2. “(Mëshirën time do ta caktoj për ata), që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon) të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Teurat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe. U lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin me ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit. Thuaj (Muhammed): “O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju. Allahu, që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës, s'ka të adhuroar tjetër pos Tij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje, pra besoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, pejgamberin e pashkolluar, që beson Allahun dhe shpalljen e Tij, ndiqni rrugën e Tij, ta gjeni të vërtetën.”<sup>3</sup>

3. “Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte

2. Kur'ani, Ali Imran: 81-82.  
3. Kur'ani, El-E'araf: 157-158.

i dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë Pejgamberëve, Allahu është i dijshtëm për çdo send.”<sup>4</sup>

### NË TEURAT, LIBRI QË IU ZBRIT HZ. MUSAIT (A.S)

1. Hz. Ymeri pyeti një ditë një rabin jehudi: “Më kallëzo se si përshkruhen cilësitë e Profetit Muhammed (a.s) në Teurat.” Ai iu përgjigj: “Ahmedi (Muhammedi) është prej fisit të Ismailit, është profeti i fundit, është profet arab, që lidhet me fenë e Hz. Ibrahimit të paqhtë, mbulon trupin, lan gjymtyrët, i ka të përskuqur sytë, ndërmjet sqetullave, kah shpina ka vulën e Profecisë, nuk është as i gjatë, as i shkurtër. Vesh rroba të lehta e jo të shtrenjta, hip në gomar e ec nëpër treg, mban shpatën në krah dhe nuk i trembet askujt, ka atë lloj faljeje (namazin) e cila, po të ishte në popullin e Hz. Nuhut, nuk do të ish mbytur në ujë, sikur të kishin këtë fe populli i Adit, nuk do të dëmtoheshin nga një furtunë e madhe dhe, po ta kishin populli i Themudit, nuk do të ishin vvarë prej presionit të atij zëri të fuqishëm.

Ai lindi në Mekë, nuk lexon as nuk shkruan, ai është lavdërues i Zotit (xh.sh), përherë në të mirë e në të ligë, sundimi i tij do të arrijë në Sham (Siri), Jordani e Palestinë. Shoku i tij është Xhebraili, persekutohet prej popullit

4. Kur'ani, El-Ahzab: 40.

të tij, por më vonë triumfon, do të luftojë në Medinë dhe jashtë saj e më në fund do të arrijë fitoren. Ka shokë që e shpëtojnë nga vdekja më tepër se uji që zbret nga mali, gjokset e tyre janë Ungjilla (Kur'ane), fi (sakrificë) për ta janë gjaku që derdhen nga trupi i tyre. Ditën janë luanë dhe natën murgj (luftojnë ditën e luten natën), armiku iu frikësohet një muaj larg. Ai lufton vetë e më vonë bëhet sundues, nuk ka policë as roje me vete.”<sup>5</sup>

2. Në Teurat, në Is'hah 33, nr.2 përmes gojës së Hz. Musait thuhet: “Erdhi Zoti nga Sinaja dhe ndriçoi prej Sairit malet afër Mekës dhe u shfaq në Malin e Varanes; ka me vete me mijëra njerëz të pastër, në dorën e djathtë mban shenjën e zjarrit (d.m.th. Kur'anin që përmend zjarrin e luftën etj), të gjithë popujt janë me të.”

Ky është testamenti i fundit, i Hu. Musait (Moisiut), prandaj aty flet për dy profetët e mëdhenj, Hz. Isain (Jezusin) e Hz. Muhammedin (a.s) dhe kallëzon se feja e Zotit (xh.sh) ka ardhur nga Sinaja, do të lindë me anë të Hz. Isait prej Sairit e do të shfaqet prej malit Farane, që d.m.th. prej Mekës.

3. Në librin e Makbukut (Teurat), në Is'hah 3, nr.3 thuhet gjithashtu: “Zoti (xh.sh) erdhi prej Tejmanit dhe i pastërri prej malit Faran, madhëria e tij ka mbuluar qiejt e u mbush toka dhe u mbulua prej lavdisë së Ahmedit që do të shpëtojë popujt.”

### NË UNGJILL, LIBRI QË IU ZBRIT HZ. ISAIT (A.S)

Dihet se Ungjilli që njihin sot kristianët përbëhet prej katër librash: Libri i Mettas (Matheut), i Merkas (Markut), i Johanit (Jovanit) dhe i Lokas (Lukës). Asnjëri nga shkruarit e këtyre librave, nuk e ka marrë nga goja e Hz. Isait, sepse disa prej tyre as nuk kanë jetuar në kohën e tij. Pra, ata kanë shkruar çfarë kanë dëgjuar, prandaj ka shumë diferenca ndërmjet tyre, ndonëse Ungjilli është zbritur vetëm njëherë. Gjendet edhe një ungjill tjetër që quhet ungjilli i Bernabas, të cilin do ta përmendim më vonë.

1. Në Ungjillin e Mateut (11-14) shënohet: “Nëse doni të pranoni faktin që ky është Iljai<sup>6</sup>, që do të vijë, ai që ka veshë, le të dëgjojë”. Po në atë Ungjill (17-11) shkruhet: “Iu përgjigj Jezui e u

5. Muhammedi, profeti i islamizmës në Teurat, në Ungjill e në Kur'an, Muhamed Tantavi, arabisht, f.7.  
6. Iljai - Ahmed.

“(Mëshirën time do ta caktoj për ata), që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon) të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Teurat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe.

U lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin me ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit.

Thuaj (Muhammed): “O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju. Allahu, që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës, s'ka të adhuroar tjetër pos Tij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje, pra besoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, pejgamberin e pashkolluar, që beson Allahun dhe shpalljen e Tij, ndiqni rrugën e Tij, ta gjeni të vërtetën.”

tha: “Iljau do të vijë dhe kthen çdo gjë”. Kjo thënie përforcon e sqaron fjalët e mësipërme.

2. Në Ungjillin e Markut, në 1-7, përsëri thuhet: “Isai thotë se do të vijë pas meje një që është më i fortë se unë. Unë ju kam larë me ujë, kurse ai do t'ju pastrojë shpirtin”.

Theksojmë se pas Hz. Isait nuk erdhi profet tjetër, përveç Profetit Muhammed (a.s).

3. Në Ungjillin e Gjonit (14-15) shënohet: “Nëse ju më doni, ruani testamentet e mia dhe unë kërkoj prej Zotit, t'ju japë një tjetër njeri të madh, i cili do të jetojë me ju. Në disa libra është quajtur me emrin Periklitatis, që në greqisht do të thotë Ahmed.

### NE UNGJILLIN BERNABANA

Ky libër është shkruar që herët dhe është përmendur në librat e shekullit të dytë e të tretë mbas Krishtit, d.m.th. para se të lindte Profeti Muhammed (a.s), në vitin 571. Ky libër e përmend emrin e Profetit Muhammed disa herë.

1. Në kaptinën 17 lexojmë: “Mirëpo do të vijë mbas meje drita e të gjithë Profetëve, e të pastërve që do të ndriçojë errësirën e fjalëve, sepse ai është i dërguari i Zotit.”

2. Në Kaptinën 36, lexojmë: “Kanë ardhur të gjithë Profetët, veç Profetit që do të vijë pas meje, sepse Zoti (xh.sh) ashtu do, që unë t'i përgatis rrugën.”

3. Në Kaptinën 44 lexojmë: “Më besoni se unë e kam parë atë (janë parë në qiell, kur erdhi Profeti Muhammed) dhe i kam paraqitur respekt, siç e ka

parë çdo Profet. Kur e pashë, u mbusha me ngushëllim e thashë: “O Muhammed, Zoti qoftë me ty dhe lutem të më bëjë të aftë për të zgjidhur lidhëset e këpucëve. Unë po të arrij në atë gradë, bëhem Profet i madh.”

### PAK FJALE PËR UNGJILLIN BERNABA

Ky Ungjill është shkruar dy shekuj pas Hz. Isait. Është i ndaluar të lexohet. I pari prift që e gjeti atë në bibliotekën e Vatikanit, quhet Fram Rinu, i cili u bë mysliman.

Ky ungjill (Bernaba) deklaroi atë që shkurt mund të përmbledhet në katër pika:

1. Hz. Isai ka mohuar se është Zot mbi ushtarët dhe banorët, burra dhe gra të Jerusalemit.

2. Djali, që Hz. Ibrahim desh të bënte kurban (të sakrifikojë), qe Hz. Ismaili dhe jo Hz. Is'haku.

3. Mesia i prituri për të gjithë botën, është Muhammedi (a.s), të cilit i përmendet emri qartas në disa vende duke thënë se është Profet i Zotit (xh.sh).

4. Hz. Isai nuk u kryqëzua as nuk u vra, apo torturua prej jehudëve, sikurse theksohet në katër ungjijtë e pranuar te të krishterët, por u mbajt në qiell te tretë dhe se ai që u kryqëzua, qe tradhtari Juhudha (Juda), të cilit iu vu në fytyrë përngjasimi i Hz. Isait.

Ky Ungjill është i përkthyer në gjuhën arabe prej gjuhës anglishte nga një kristian libanez.



**Durim Kasemi,**  
Imam - xhamia Parrucë

## DISA PYETJE RRETH NAMAZIT

ky ajet. Cilat janë ato pyetje që zgjon ky ajet?

A ndikon tek ne namazi në këtë mënyrë siç është shprehur në ajet?!

A na largon namazi jonë nga veprat e këqija dhe të ndaluara siç pohon ky ajet?

A ka gjurmë të namazit pasi dalim prej tij, në ndërgjegjen tonë dhe në zemrat tona?

Apo, ne pasi dalim nga namazi jemi të njëjtë, ashtu sikur ishim para se të hynim në namaz?! Nëse është kështu atëherë marrëdhënia jonë me namazin ka nevojë për ndryshim e rregullim.

A thua vallë mjafton që vetëm të falem fizikisht apo mos duhet diçka më tepër?

Sikur të na jepej mundësia për të vlerësuar me notë namazin tonë, çfarë note do i vendosnim? Ose nëse do vlerësohej namazi jonë me notë në këtë dynja, çfarë note mendojmë se do merrnim? Këto pyetje duhet t'i bëjmë vetes shpesh, sepse janë pyetje që na rizgjojnë dhe na kthejnë vëmendjen tek namazi.

Një ditë Pejgamberi (a.s) foli për namazin dhe tha: "Kush kujdeset për pesë namazet, ai do të shpëtojë ditën e gjykimin dhe namazet për të do jenë dritë e argument. Dhe kush nuk kujdeset për to, ai do humbasë ditën e gjykimin, e nuk do ketë dritë e as argument"

Në këtë hadith Pejgamberi (a.s) ka përdorur fjalën (hafidh) që ka kuptimin "ruan", "kujdeset", por që përcjellë më shumë se sa fjala fal apo kryen. Pra ruan dhe kujdeset për namazin e tij që ta falë siç duhet, në kohën e tij, në formën e tij, në përmbajtjen e tij, në esencën e tij.

Ka dallim shumë të madh mes namazit të vërtetë, i cili është lidhje e vërtetë me Allahun dhe atij namazi që është thjeshtë kryerje e një riti sa për të "shlyer borxhin" siç mund të thonë disa.

Ebu Hurejra tregon se një person hyri në xhami dhe filloi të falej. Pasi kreu namazin shkoi tek Pejgamberi (a.s) dhe e përshëndeti me selam, dhe Ai ia ktheu

selamin dhe i th: "Shko falu sepse ti nuk je falur" - dhe kjo ndodhi tre herë - dhe të tretën, burri i tha: Pasha Atë që të ka dërguar, unë nuk di të falem ndryshe, prandaj më mëso. Pejgamberi (a.s) i tha: "Kur të fillosh namazin bëj tekbir (thua: Allahu Ekber), e pastaj lexo çfarë të dish nga Kur'ani, e pastaj bëj rukunë dhe qëndro e qetësohu në të, e pastaj ngrihu nga rukuja e qetësohu në këmbë, e pastaj bjer në sexhde e qetësohu, e pastaj ngrihu e qetësohu dhe kështu vepron në të gjithë namazin tënd". - (Buhariu)

A thua vallë sikur të na shikonte Pejgamberi duke u falur çfarë do na kishte thënë për namazin tonë? A thua do na kishte kthyer tri herë apo më shumë? A thua vallë do e kishim kaluar testin e namazit vetëm nga përjashta përpara Pejgamberit (a.s)?!

Në suren Mu'minun, në ajetet 1 dhe 2, Allahu thotë: "Pa dyshim që besimtarët janë të shpëtuar, ata të cilët e falin namazin e tyre me frikërespekt".

Ky ajet na tregon se: Besimtarët janë të shpëtuar në ahiret dhe se cilësia e parë e këtyre besimtarëve të shpëtuar është falja e namazit, por jo vetëm thjeshtë falje por me "frikërespekt". Çfarë do të thotë "frikërespekt" (shushu)? Kjo fjalë nënkupton fokusim të plotë fizik dhe shpirtëror e mendor në veprimin që kryhet, pra namazin.

Aishja (r.a) ka thënë: E kam pyetur Pejgamberin (a.s) për kthimin e kokës - sa majtas djathtas - në namaz, e Ai më tha: Kthimi, është vjedhje që shejtani i bën namazit të njeriut". - (Buhariu)

Nëse lëvizja fizikisht në namaz konsiderohet vjedhje që i bëhet namazit, atëherë po nëse ne lëvizim dhe kthehem mendërisht dhe shpirtërisht gjatë namazit çfarë është, kur e dimë se përqendrimi shpirtërisht dhe mendërisht është esenca dhe shpirti i namazit.

Drejtimi nga kibla fizikisht në namaz është prej parakushteve që pa të, namazi nuk bën. Por edhe drejtimi shpirtërisht dhe mendërisht kah Allahu në namaz

është kusht që pa të namazi nuk bën.

Namazi përmban brenda vetes shumë element që duhet t'ia kujtojnë njeriut Zotin, ta mbajnë atë të lidhur me të edhe pasi të ketë dalë prej tij dhe kështu largohet nga e keqja.

Duke filluar qysh te qëllimi dhe nijeti me të cilin hymë në namaz, i cili është thelbësorë në këtë mes. Njeriu duhet të kujdeset që të sjellë në mendje sa herë që fillon namazin nijetin për të cilin po lutet, sepse kështu ai di se çfarë po bën dhe përse po e bën.

Pse po falem, çfarë po bëjmë? Janë pyetje që duhen shtruar shpesh herë brenda vetes tona, në mënyrë që të shikojmë ku jemi dhe si po ecim dhe çfarë jemi duke bërë, në mënyrë që të mos biem viktimë të rutinës pa e kuptuar.

A e dimë se cila është rutina këtu?

Të falësh namazin, sepse të është bërë pjesë e ditës tënde dhe duhet ta kryesh dhe të mos ndjesh asgjë tjetër kur e fal, përveçse ke kryer një "borxh".

Sepse po të ishte kështu, nuk do kuptohej hadithi i pejgamberit (a.s) ku thotë: "Fale namazin, sikur të jetë i fundit për ty". - (Ibn Maxheh)

A e dini pse namazet janë të shpërndara në pesë kohë dhe jo në një kohë të vetme? Sikur të ishte kjo punë thjesht larje borxhi do ishte bërë një herë në ditë, kurdo që do ishte e mundur dhe kaq por, siç thonë dijetarët se namazet janë bërë pesë herë në ditë të shpërndara brenda 24 orëve, kryesisht në kohët kur njeriu është zgjuar, për ta mbajtur njeriun të lidhur me Zotin gjatë gjithë kohës dhe për të pakësuar në maksimum hapësirat kohore gjatë të cilave dobësohet lidhja e njeriut me Zotin si pasojë e natyrës njerëzore dhe natyrës së jetës në këtë botë.

Nga shenjat që na tregojnë se namazi jonë është në rregull janë disa, por po përmend vetëm një dhe ajo është të ndjerit rehat në namaz, ashtu sikur Pejgamberi (a.s) është ndërë dhe e ka shijuar namazin, siç edhe i thoshte Bilalit (r.a): "Na qetëso me namaz o Bilal!" - (Ebu Davudi). A gjemë qetësi dhe prehje në namaz, apo duam ta heqim qafe e ta kryejmë?! Peshore e rrezikshme është kjo thënie e Pejgamberit (a.s).

T'i lutemi Allahut pas çdo namazi farz ashtu sikur Pejgamberi (a.s) e ka mësuar Muadh ibn Xhebel kur i ka thënë: "Mos e lër kurrë pa thënë pas çdo namazi farz: O Allah më ndihmo që të përkujtoj Ty, të falënderoj Ty, e të adhuroj Ty në formën më të mirë e më të përkryer". - (Ebu Davudi)

## NJË XHAMI E RE HIJESHON HYRJEN E QYTETIT TË SHKODRËS

Endërtuar rrëzë urës së vjetër të Bunës, mbi truallin vakëf ku për shekuj ka qëndruar një tjetër xhami e shkatërruar nga regjimi komunist, sot ngrihet një xhami e bardhë, e ndërtuar me gurë të sjellë enkas nga Berati. Kjo është një xhami e ndërtuar tërësisht me kontributin personal dhe nën mbikqyrjen e biznesmenit shkodran Haxhi Gani Kryeziu.

Pikërisht sot, në 28 vjetorin e rihapjes së Xhamisë së Plumbit në Shkodër nga djelmnia shkodrane, ku protagonist ishte edhe vetë Haxhi Ganiu, dhe faljes së xhumasë së parë pas komunizmit, është inauguruar edhe kjo xhami e re.

Në inaugurim morën pjesë Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë H, Skënder Bruçaj, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, biznesmeni Gani Kryeziu si dhe shumë të ftuar të tjerë.

Pas këndimit të kuranit nga hafizi Shykry Kapllan, fjalën e rastit e mbajti Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari, i cili ndër të tjera theksoi se: "Dita e përirimit të xhamisë së re te Ura e Bunës, mbi të njëjtin vakëf, ku dekada dhe shekuj më parë ka ekzistuar përherë xhamia, përkon me një datë të shenjtë për mbarë myslimanët e Shkodrës, Shqipërisë dhe trojeve shqiptare, 16 nëntorin. Është kjo datë që na kujton finalizimin e madh të përpjekjeve të djemve të rinj shkodranë, në mesin e të cilëve edhe miku jonë, Gani Kryeziu, për të rihapur të vetmen xhami të

ngelur në këmbë, Xhaminë e Plumbit, pas çmendurisë komuniste, që dhunoi dhe shkatërroi krejt xhamitë tona, duke damkosur Shkodrën dhe Shqipërinë me damkën më të turpshme të historisë, asaj që kaloi dhe asaj që vjen, deri në kijamet!"

Kryetari i KMSH, H. Skënder Bruçaj, në fjalën e tij shprehu gëzimin që biznesmenët shqiptarë po kontribuojnë dhe po ndërtojnë xhami për hir të Allahut dhe ky është një model i mirë për tu marrë shembull nga besimtarët biznesmenë. Ai theksoi se inaugurimi i kësaj xhamie në këtë ditë të xhuma të muajit të bekuar të Mevludit, e cila përkon edhe me një datë të rëndësishme për mbarë besimtarët myslimanë të Shqipërisë, me 16 Nëntorin 1990 kur u hap xhamia e parë dhe u fal xhumaja e parë pas komunizmit, merr një dimension tjetër, pasi vetë Haxhi Ganiu ka qenë ndër nismëtarët e hapjes së xhamisë së plumbit dhe sot Allahu ja mundësoi që me të ardhurat e veta të ndërtojë një xhami të bukur, e cila do të hijeshojë qytetin e Shkodrës.

Në mbyllje të ceremonisë, donatori dhe ndërtuesi i xhamisë, Z. Gani Kryeziu falënderoi të pranishmit dhe shprehu gëzimin e përfundimit të kësaj xhamie e cila nga sot do të jetë e hapur për besimtarët.

Më pas u mbajt edhe hytbeja nga Myftiu i Shkodrës dhe u fal xhumaja e parë në këtë xhami.

(<http://www.kmsh.al>)



## LIGJËRATA MBI SHEMBULLIN E RESULLULLAHUT (A.S.) GJALLËROJNË XHAMITË E SHKODRËS

Sikurse është lajmëruar, nga data 1 nëntor 2018 e në vijim, Myftinia Shkodër ka nisur një cikël të ri të ligjëratave me temë: “Resullullahu (a.s.) – shembulli më i përsosur”, që po zhvillohen në xhamitë e fshatrave.

Ky projekt ka për qëllim të gjallërojë jetën fetare në xhamitë tona, si dhe të afrojë në vëmendjen e besimtarëve shembullin e përsosur të Hz. Muhammedit (a.s.).

Gjatë këtij projekti ishin planifikuar 11 tribuna fetare, ku imamët dhanë mesazhe me vlerë që zgjojnë zemrën dhe e ushqejnë atë me dritë besimi, duke iu referuar



SHIROKË - 1.11.2018

vlerës që ka leximi dhe nxjerrja në pah e jetës dhe shembullit të Hz. Muhammedit (a.s.) të dërguarit të All-llahut si mëshirë për mbarë botët.

Në këtë projekt u përfshinë xhamitë e fshatrave: Shirokë, Bardhaj, Boks, Kullaj, Trush dhe Barbullush, Bërdicë e Mesme, Kosmaç, Ganjollë, Zues dhe Shtoj i Vjetër, ku ligjëruan imamët dhe teologët e nderuar: Lavdrim Hamja, Idmir Plaku, Adrian Uraj, Adil Cukali, Naim Drijaj, Adem Pizga, Gilman Kazazi, Ervil Kuçi, Altin Nikshiqi, Durim Kasemi dhe Arben Halluni.



BARDHAJ - 2.11.2018



BOKS - 3.11.2018



KULLAJ - 4.11.2018



TRUSH - 5.11.2018



BARBULLUSH - 6.11.2018



BËRDICË E MESME - 7.11.2018



KOSMAÇ - 8.11.2018



GANJOLLË - 9.11.2018



ZUES - 10.11.2018



SHTOJ I VJETËR - 11.11.2018



**PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:**

*“Më të mirët  
e ymetil tim janë  
ata që thërresin  
drejt All-llahut  
dhe i bëjnë robët  
e Tij të dashur  
për Të!”*

(Ibn Nexhari, nga Ebu Hurejra)



## MYFTIU PRITI KRYETARIN E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM TË KMSH

Paraditën e së hënës, më 12 nëntor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim pune, Kryetarin e Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Islam Hoxha, që shoqërohej edhe nga Myftiu i Tropojës, z. Eduart Demiraj.

Gjatë takimit, Myftiu bëri një prezantim të aktivitetit të Myftinisë Shkodër për vitin 2018, duke u bazuar tek disa prej aspekteve të këtij aktiviteti, si: jeta fetare e xhamive, ana ekonomike, çështja e pronave dhe shfrytëzimi i tyre, ndërtimi i xhamive të reja, marrëdhëniet ndërfaqetare, marrëdhëniet me institucionet e natyrshme vendore, mediat, botimet periodike, si: Buletini i përvitshëm, gazeta "Udha Islame", përmbledhjet e ligjëratave dhe konferencave, etj.

Myftiu informoi vizitorët edhe për përfundimin e ciklit të parë të ligjëratave



11 ditore me temë: "Resulull-llahu (a.s.) – shembulli më i përsosur", si dhe programin e përgatitur me rastin e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s.).

Nga ana e tij, z. Hoxha u interesua për aktivitetin e Myftinisë Shkodër

në rang lokal, për gjallërimin e xhamive, problematikat e vakëftit, sikurse përgëzoi Myftininë e Shkodrës për aktivitetin e gjerë, aktivizimin e kuadrit fetar, gjallërimin e jetës fetare nëpërmjet ligjëratave të përjavshme dhe aktivitetëve në përgjithësi.

## "MIRË SE VJEN RESUL I PRITUN", ME RASTIN E MEVLUDIT 1440

Ditën e hënë, më 19 nëntor 2018, pas namazit të akshamit në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër organizoi tubimin me temë: "Mirë se vjen Resul i pritun", me rastin e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s.).

Aktiviteti ishte ndërthurrur me ligjëratë, këndime e recitime, nëpërmjet të cilave u përcoll mesazhi i ripërtëritjes së besës dhe dashurisë për të Dërguarin e All-llahut, Hz. Muhammedin (a.s.), Vulën e të Dërguarve, mëshirën e dhuruar, udhëzuesin drejt Dritës, shpëtimtarit të njerëzimit nga devijimi dhe injoranca e idhujtarisë.

Pas leximit të disa ajeteve kur'anore, në fjalën e rastit, teologu Lavdrim Hamja vlerësoi ditën e lindjes së Hz. Muhammedit (a.s.) si një bekim të madh për gjithësinë, si dhe si një moment që na përkujton mirësinë e madhe të All-llahut ndaj nesh.

Aktivitetin e përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi se përherë kemi nevojë t'i kujtojmë njëri-tjetrit madhësitinë e të Dërguarit të All-llahut, Zotërisë tonë, Hz. Muhammedit (a.s.), si shembull i përkryer, që na mjafton për këtë botë dhe të përtejmen.



Njëkohësisht theksoi se tubime të tilla kanë bekimet e All-llahut, si dhe gjallërojnë zemrat me përmendjen e emrit dhe jetës së më të mirit të njerëzisë.

Aktiviteti u zbulua me këndimet e të nderuarit H. Sami Muçej, që lexoi një pjesë nga poema e Hafiz Ali Ulqinakut kushtuar lindjes së Hz. Muhammedit (a.s.), si dhe disa nga ilahitë e bukura të zonës së Shkodrës.

Ligjëratë kryesore u mbajt nga

teologu Sabaudin Jashari, i cili bëri disa krahasime në mes kohës sonë dhe asaj të sahabëve, sikurse kërkoi nga të pranishmit që të shohin me optimizëm çdo të mirë dhe kontribut që japin për fenë dhe shoqërinë, duke e përfytyruar të Dërguarin të pranishëm.

Në fund, u recituan edhe disa pjesë të përzgjedhura nga krijimtaria kushtuar Pejgamberit tonë, që u interpretuan me ëmbëlsi nga medresistët Enes Mandi dhe Asim Elezi.

Mbrëmjen e së hënës, më 19 nëntor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ishte i ftuar në Star Plus tv, ku iu përgjigj pyetjeve të gazetarit Erzen Koperaj, në lidhje me përkujtimin e Lindjes së të Dërguarit të All-llahut, Hz. Muhammedit (a.s.).

Gjatë bashkëbisedimit, Myftiu hodhi dritë edhe mbi mesazhet që përcjell tek ne përkujtimi i 16 nëntorit 1990, ditës historike të xhumasë së parë masive pas diktaturës komuniste. Ai vlerësoi kontributin e hoxhallarëve të shkuar shkodranë, sikurse theksoi se, përtej dhunës dhe terrorit komunist, shqiptarët vijuan të mbanin mbi supë vlerat e diturisë dhe Thirrjes Islame në botën e lirë. Këtu përmendi dijetarët me përmasa botërore, si: Shejkh Vehbi Gavoçi, Imam Vehbi Ismaili, Shejkh Shuajb Arnauti, Shejkh Nasirudin El-Albani, Shejkh Abdulkadir Arnauti, etj.

Një pjesë të madhe të bashkëbisedimit, iu kushtua personalitetit dhe mesazhit të Vulës së të dërguarve të Zotit, Hz. Muhammedit (a.s.), ku Myftiu theksoi se, mbi të gjitha, zotëria i njerëzimit dhe i mbarë të dërguarve, ishte Njeri, që jetoj një jetë për t'u marrë shembull deri në kiamet.

## MYFTIU: "HZ. MUHAMMEDI (A.S.), SHEMBULL GARANT DERI NË KIJAMET!"



Ai tha se çdo veprim a sjellje e tij, ishte dhe mbeti pikë referimi për njeriun e çdo kohe, sa të ketë jetë mbi tokë. Këtë e pasoi me shembuj konkret nga shembulli i Hz. Muhammedit (a.s.) dhe madhështia e tij si: prind, bashkëshort, gjysh, prijës elitar, dialogues me tjetrin, i urtë e largpamës, mbi të gjitha përçues

besnik i Fjalës së Zotit, Kur'anit, që nuk ndryshoi, as mund të ndryshojë deri në kiamet!

Myftiu shpjegoi edhe disa hadithe, që lidhen me distancimin nga ekstremizmi në fé, koprancia e pabesia, sikurse u ndal tek kuptimet e lutjes së atij që i është bërë padrejtësi.

## MYFTIU LIGJËROI PARA MATURANTËVE TË MEDRESESË

Në vazhden e aktivitetëve me rastin e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s.), ditën e martë, më 20 nëntor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti një ligjëratë para maturantëve të Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", dega djem.

"Kërkimi i dijes është obligim për çdo musliman", ishte porosia e shenjtë e të Dërguarit të All-llahut, rreth së cilës Myftiu tërhoqi vëmendjen e djemve tanë se, ka shumë rëndësi shoqërimi me njerëz të ditur dhe të urtë gjatë procesit të marrjes së dijes, sidomos të asaj dije, që lidhet me besimin dhe fenë.



Myftiu kërkoi nga djemtë e rinj që të mos ndalet asnjëherë përpjekja drejt përvetësimit të shpirtit të traditave të Hz. Muhammedit (a.s.) në jetën e përditshme. Ai tha se shembullin e të Dërguarit të All-llahut e kemi udhëzim shërues deri në kiamet, prandaj nuk ka pse të kërkojmë për alternativa të tjera në jetë.

Aktivitetin e përshëndeti fillimisht z. Kujtim Dervishi, drejtor i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia". Ai vuri theksin tek modeli i suksesshëm i Medresesë dhe vlerësoi përkujtimin e ditës së Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s.) si një moment angazhimi në jetën e çdo muslimani.

**D**itën e mërkurë, më 21 nëntor 2018, pas namazit të iqindisë në xhaminë "Ebu Bekër", Myftinia Shkodër organizoi një takim me motrat muslimane, me temë: "Më i miri prej jush, është më i mirë me familjen e tij".

Aktiviteti, që kishte në thelb porosinë e shtrenjtë të Hz. Muhammedit (a.s.), u fokusua tek rëndësia e edukimit të fëmijëve me frymën e besimit dhe dashurisë për All-llahun, Librin e Tij, Kur'anin Famëlartë dhe të Dërguarin mëshirë për gjithësinë, Hz. Muhammedin (a.s.), si burime garante të një jete me dinjitet e krenari.

Ligjëruan vajzet Ferzet Ndoja, Zamira Puka dhe Jetmira Plaku, të cilat hodhën

## FAMILJA DHE EDUKIMI I FËMIJËVE NË VËMENDJEN E MOTRAVE MUSLIMANE



dritë mbi vlerat e ajeteve dhe haditheve që nxisin përkujdesjen për familjen, ruajtjen e saj nga devijimi dhe shthurja, edukimin e drejtë të fëmijëve, kultivimin e harmonisë dhe mbrojtjen e tabanit të kësaj çerdheje, që garanton trashëgiminë e jetës sipas vullnetit të Krijuesit.

Tubimi u shoqërua edhe me recitime dhe duanë e Hatmes së Kur'anit.

Aktivitetet me rastin e përkujtimit të Lindjes së Hz. Muhammedit (a.s.) do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, sipas programit të paracaktuar nga Myftinia Shkodër.

## MYFTIU: "RESULLULLLAHU NA MËSOI SI TA KTHEJMË TË KEQEN ME TË MIRË, NË POZITA FORCE!"

**M**brëmjen e së enjtes, më 23 nëntor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ishte i ftuar në emisionin "Perspektivë", në Tv1 Channel, ku hodhi dritë mbi personalitetin e Hz. Muhammedit (a.s.), veçorive të thirrjes së tij, madhësisë së Kur'anit Famëlartë, etj.

Gjatë bashkëbisedimit me gazetaren Linda Kavaja, ai theksoi se Resullull-llahu (a.s.) u dërgua si vullë e krejt të dërguarve të mëparshëm, që kishin një thirrje dhe një udhëzim, që u plotësua me dërgesën universale të të fundit prej të dërguarve të Zotit Një.

Myftiu tha se, përtej vuajtjeve, lëndimeve dhe sakrificave të mëdha në jetën e thirrjes së tij, Hz. Muhammedi (a.s.) na mësoi të kthejmë të keqen me të mirë, në pozita force, jo të poshtëruar!

Njëkohësisht shpjegoi se, thirrja e Hz. Muhammedit (a.s.) ishte për mbarë botët, jo për arabët, që gjithsesi, i nxori nga injoranca e thellë në një realitet të ndriçuar nga udhëzimi i Kur'anit. Mosrespektimi i femrës, fajdet,



padrejtësitë shoqërore, idhujtaria, sistemi i trashëgimisë, borxhi, imoraliteti e shumë vese të tjera të përhapura, u shëruan falë ajeteve dhe udhëzimeve të shenjta në një periudhë 23 vjeçare.

Myftiu bëri thirrje që shqiptarët të kthehen nga feja e All-llahut dhe të mos humbin kohën duke eksperimentuar me femohim e afetarizëm, sepse historia e shkurtër kombëtare është vërtetuesi më

i mirë se larg fesë, shqiptarët përjetuan një dekadencë të frikshme.

Ai tha se, Islami ka ardhur për të dhuruar shpresë dhe optimizëm, dera e pendimit nuk mbyllet dhe se të gjithë jemi të gabueshëm dhe të mundur për të ndryshuar jetën, duke ia dorëzuar vullnetit të thirrjes së Krijuesit, që di më së miri se, çfarë i nevojitet njeriut për jetën dhe të ardhmen e tij.

## HYTBE E UNIFIKUAR MBI MADHËSHTINË E DËRGESËS UNIVERSALE TË HZ. MUHAMMEDIT (A.S.)

**M**e porosi të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ditën e xhuma, më 23 nëntor 2018, në të gjitha xhamitë e Shkodrës u mbajt hytbeja e unifikuar, kushtuar dërgesës së Hz. Muhammedit (a.s.) për mbarë njerëzimin dhe mëshirë për botët.

Nga minberi i xhamisë së fshatit Bardhaj, Myftiu theksoi se detyra e muslimanëve në hak të Resullull-llahut (a.s.) sot, është përhapja e dritës së udhëzimit të tij, duke e nxjerrë atë nga xhamia e shtëpia, në çdo vend dhe me këdo.

Myftiu tha se, Hz. Muhammedi (a.s.) u dërgua për ta shpëtuar identitetin e njeriut dhe për ta kthyer atë nga rrugëtimet e shfrenuara drejt dekadencës, ku kishte rënë.

"All-llahu i Madhëruar na lartësoi si besimtarë, duke na kërkuar t'i



bashkangjitemi bekimeve dhe mëshirës që Zoti i gjithësisë dhe melekët i dërgojnë atij! Duhet të ndjehemi më fatlumët e botës për faktin që jemi pjesë e ymetit

të Hz. Muhammedit (a.s.), të dërguarit me mesazhin e plotë dhe udhëzimin, në të cilin nuk ka mangësi!" – tha, ndër të tjera Myftiu.

## PROJEKTI: "LEXOJMË, KUPTOJMË, LARTËSOHEMI" ME RASTIN E MEVLUDIT SHERIF

**P**araditën e shtunë, më 24 nëntor 2018, në xhaminë e "Dy vajzave", Myftinia Shkodër, në vazhden e përkujtimit të Mevduhit Sherif, zhvilloi projektin: "Lexojmë, kuptojmë, lartësohemi". Në këtë projekt morën pjesë nxënës të disa kurseve fetare të xhamisë Bardhaj, Golem, Barbullush dhe "Dy vajzat".

Përgjegjësi i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni në fjalën e tij përshëndetëse u ndal te rëndësia dhe vlera e madhe e përkujtimit të Ditëlindjes së Begatë të Profetit Muhammed (a.s.), si figura më e ndritur e njerëzimit, që përçoi gjithmonë vlerat e besimit të vërtetë, moralit të pastër, paqes dhe harmonisë më të gjitha krijesat e Zotit në tokë.

Pas fjalës së teologut Halluni, filloi projekti në fjalë me leximin e "111 Haditheve Profetike" botim i Myftinisë Shkodër, të cilat mbajnë porosi tepër të vlefshme për jetën njerëzore dhe që japin garanci




për çdo njeri të jetojë i paqhtë dhe i qetë me veten dhe me të gjithë njerëzit, madje me mbarë krijesat e Zotit.

Secili nxënës pjesëmarrës në këtë projekt lexoi nga 2-3 hadithe profetike, të cilat here pas here u shoqëruan me komente të shkurtra nga teologët dhe imamët mësues të kurseve të mësim-besimit.

Në fund për nxënësit pjesëmarrës u shtrua një kokejll.

16 NËNTOR 2018  
INAUGURIMI I XHAMISËSË RE  
TEK URA E BUNËS



*Botues:*  
**Myftinia Shkodër**  
*Drejtues:*  
**Imam Muhamed Sytari**

*Kryeredaktor:*  
**Lavdrim Hamja**

*Tel / Fax:*  
**+355 (0) 224 2081**  
*Nr. llogarie:*  
**100054 UBA - Shkodër**

   
**MYFTINIASHKODER1990**  
**udhaislame@myftinia-shkoder.org**  
**www.myftinia-shkoder.org**